



PËRSE ËSHTË SHQETËSUES RADIKALIZMI FETAR DHE EKSTREMIZMI I DHUNSHËM?

Veprimet e ekstremistëve të dhunshëm kërcënojnë të drejtat e njeriut, demokracinë, sigurinë etj., duke shkaktuar vdekje dhe luftra. Me shfaqjen e grupeve terroriste fetare është shtuar nevoja e ndërgjegjësimit të dallimeve midis një praktikuesi fetar dhe një ekstremisti.



Ndërgjegjësimi i qytetarëve ndaj këtyre fenomeneve është i rëndësishëm në mënyrë që ata t'i shmangen veprimtarive ekstreme dhe radikale.



SI MUND TE PARANDALOHEM KËTO FENOMENE?

Masat për parandalimin dhe riintegrimin e personave të radikalizuar në shoqëri, nuk duhet të jenë shtypëse, por duhet të konsistojnë në një tërësi politikash të ndërmarra nga autoritetet shtetërore. Këto politika duhet të fokusohen në krijimin e urave të komunikimit me individët më vulnerabël në komunitetet që kanë më shumë mundësi të preken nga ky fenomen. Në mënyrë që këto fenomene të parandalohen është e rëndësishme që qytetarët të informohen në lidhje me rrezikun që ato paraqesin për ta dhe për komunitetin.

Ky botim u realizua me mbështetjen e:



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Powering new generations against extremism



Ju mirëpresim në forumet dhe diskutimet tona.



QENDRA EUROPIANE

Rr. Vaso Pasha
P. 20, Ap. 57, 1001
Tiranë, Shqipëri

info@euro-centre.eu

www.euro-centre.eu

PËRBALLË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT FETAR


Dhuna në emër të fesë, rreziku që paraqet për komunitetin dhe si të parandalojmë fenomene të tilla

RADIKALIZIMI FETAR

Radikalizimi fetar konsiston në akte të dhunshme në emër të fesë të cilat mund të çojnë deri në terrorizëm. Komisioni Evropian e përcakton radikalizmin si një "fenomen që i bën njerëzit të përqafojnë opinione, pikëpamje dhe ide që mund të çojnë në akte terroriste".

Radikalizimi nuk është një proces që zhvillohet në mënyrë të njëtrajtshme, por është një proces i cili zhvillohet në bazë të kontekstit shoqëror dhe të disa faktorëve individualë.

Arsyet përse një individ mund të radikalizohet janë të shumta: mosintegrimi në shoqëri, problemet ekonomike, papunësia, mosangazhimi në jetën politike apo ndërveprimi me elementë ekstremist, që mund të jenë individë, grupe apo organizata.



Sot feja po përdoret si një justifikim për radikalizëm fetar dhe ekstremizëm të dhunshëm nga organizata terroriste si ISIS, Boko Haram, Talibanët, Al-Kaida etj. Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi fetar janë koncepte që lidhen me njëra-tjetrën, por nuk janë identike.

Për këtë arsye, është e rëndësishme që qytetarët të informohen në lidhje me këto koncepte në mënyrë që t'i identifikojnë ato.

EKSTREMIZMI I DHUNSHËM

Numri i viktimave si pasojë e ekstremizmit të dhunshëm ka qenë në rritje që prej vitit 2001. Atentatet që prekën Evropën gjatë vitit 2015 treguan se rreziku i ekstremizmit të dhunshëm është mjaft i lartë.

Studiuesit e përkufizojnë ekstremizmin e dhunshëm si një mendim që parapërcakton mënyrat e sjelljeve të dhunshme. Ndryshe nga radikalizmi, nuk ekziston asnjë tolerancë ndaj diversitetit dhe dhuna është e justifikuar.

Shprehja "ekstremizëm i dhunshëm" përshkruan shtysën dhe veprimet e personave që mbështesin apo përdorin dhunën për të arritur qëllime ideologjike, fetare apo politike. Të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm, pavarësisht nga motivi, kërkojnë të sjellin një ndryshim përmes frikës, në vend të metodave demokratike.

LIRIA E BESIMIT FETAR

Liria e besimit fetar është një e drejtë themelore e njeriut e cila mbrohet nga neni 9 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Çdokush ka të drejtën e lirisë së fesë e cila garantohet nga neni 24 i Kushtetutës Shqiptare. Kushtetuta parashikon barazinë dhe pavarësinë e fesë.

Të gjithë janë të lirë të shprehin besimin e tyre fetar në mënyrë individuale ose në grup, pa patur frikë nga kërcënimet, diskriminimet ose dhuna.

Liria e fesë është një kusht i rëndësishëm për demokracinë, shtetin e së drejtës dhe stabilitetin e një vendi.

Liria e fesë ka dy komponentë kryesorë:



e drejta për të mos ushtruar dhe/ose për të ndryshuar fenë;



e drejta për të shprehur bindjet fetare, në mënyrë individuale ose në komunitet.